



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KA.nr.384/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtarja Vlora Pacolli-Rexhepi, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit N.SH.H ZONA PARK me seli në Prizren rr “Parku i Qytetit”, me përfaqësues të autorizuar av.Arbnor Murturi, kundër të paditurës Organi Shqyrtues i Prokurimit me seli në Prishtinë për shkak të anulimit të Vendimit me PSH.Nr.229/20 të datës 27.04.2020, jashtë seancës, me datë 25.04.2024 merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. **KONSTATOHET** e tërhequr padia e paditësit .SH.H ZONA PARK me seli në Prizren, kundër të paditurës Organi Shqyrtues i Prokurimit me seli në Prishtinë për shkak të anulimit të Vendimit me PSH.Nr.229/20 të datës 27.04.2020.
- II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta.

A r s y e t i m

Paditësi SH.H ZONA PARK me seli në Prizren me datën 29.05.2020, i përfaqësuar sipas autorizimit të datës 04.03.2024 nga Arbnor Murturi Avokat Aga Zyra e Avokatëve “Laë” ka parashtruar padi, kundër të paditurës Organi Shqyrtues i Prokurimit me seli në Prishtinë për shkak të anulimit të Vendimit me PSH.Nr.229/20 të datës 27.04.2020.

Me datë 12.04.2024 në gjykatë ka përfaqësuesi i paditësit ka dorëzuar parashtresë për tërheqjen e padisë, konform nenit 63 të LPK-së lidhur me nenin 261 të LPK-së, duke i propozuar gjykatës që të nxjerr aktvendim me të cilin e konstaton si të tërhequr padinë e paditësit, me arsyetim kontratat

publike ka përfunduar në vitin 2020, dhe gjykata nuk ka arritur ta shqyrtoj padinë brenda një afati të arsyeshëm prandaj tani nuk ka më efekt juridik që paditësi ti realizoj te drejtat legjitime.

Konform nenit 263.3 të LPK gjykata vendosi si në dispozit të këtij aktvendimi. Vendimi për shpenzimet procedurale u morë në bazë të nenit 64 të LKA-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë Departamenti i Përgjithshëm

Ka.nr.384/22, datë 25.04.2024

Gjyqtarja
Vlora Pacolli Rexhepi

KËSHILLA JURIDIKE : Konform neni 263.4 të LPK-së, Ankesa kundër këtij nuk është e lejuar.